| 2 | Geri Bledar Pirja | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 5 | — | Bursa e plote |
| 3 | Leandro Nikollaq Ziu | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 2 | — | Bursa e plote |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Edison Altin Domi | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat. Drejtimi Mekanik. | 9000 | 1 | 9000 | Bursa e plote |
| 5 | Eldison Tafil Vaisllari | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 6 | Daut Ismet Hoxha | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Elektronike | 40000 | 2 | 20000 | Bursa e plote |
| 7 | Roela Besnik Alimetaj | Shkolla e Mesme Pofesionale "Kristo Isak" Berat Drejtimi mesimor Sherbime Sociale dhe Shendetsore. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 8 | Glarentiola Sulo Kapllani | Shkolla e Mesme Pofesionale "Kristo Isak" Berat Drejtimi mesimor Hoteleri-Turizem. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 9 | Artur Përparim Lamaj | Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Cela" Durres.Drejtimi mesimor Hoteleri-Turizem. | — | 4 | — | Bursa e plote |

**Drejtoria Juridike dhe MBNJ**

**Erion PLAKU**

**DREJTORI I Q.E.ARSIMIT**

**Kozeta MARA**

2025

**SEKRETARI I KESHILLIT BASHKIAK**
**Alda HODO**

**KRYETARI I BASHKISE**
**Kreshnik HAJDARI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA KUÇOVE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT
BASHKIA KUCOVE

Adresa : Sheshi "18 Tetori" , Blloku "Tafil Skendo" , Lgj. Nr. 1 , Kuçove . Tel. 031122912

**Nr.** 43ff **Prot.** **Kuçove , me** 05/12/ **2025**

# RELACION

## KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË

**Lenda :** Mbi shqyrtimin e dokumentacionit per dhenien e bursave per nxenesit e Arsimit Parauniversitar ne Institucionet Arsimore Publike qe vazhdojne vitin e pare per vitin shkollor 2025-2026.

Mbeshtetur ne shkresen e Ministrise se Arsimit dhe Sportit me nr. Prot 973/1, te dates 29.10.2025 per Bashkine Kucove, jane miratuar 15 (pesembedhjete) bursa per nxenesit qe ndiekin vitin e pare ne shkollat e mesme ne arsimin profesional per vitin mesimor 2025-2026, VKM Nr 666 date 10.10.2019 te Keshillit te Ministrave "Per kuotat financiare te ushqimit ne menca e konvikte, percaktimin e kritereve per perfitimin e bursave dhe pagesave per nxenesit e Arsimit Parauniversitar ne Institucionet Arsimore Publike" per vitin shkollor 2025-2026.

QEA prane Bashkise Kucove, ka bere njoftimin per aplikantet duke u lene kohe sipas afatit te percaktuar ne VKM, dhe rezultoi se kishte gjithsej 9 (nente) kerkesa aplikimi. Sipas kritereve per te perfituar burse te plote per nxenesit ne nevoje, jane bere verifikimet e dokumentacioneve te paraqitura dhe rezultoi se 9 (nente ) kerkese-aplikimet e bera plotesonin kriteret per te perfituar burse .

Sipas kriterit ekonomik:

a)Nxenesit e Arsimit Parauniversitar që vazhdojne studimet në largësinë mbi 5 (pese) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre,e qe plotesojne kriterin ekonomik.

Jashtë kriterit ekonomik:

a) Nxenes që kanë përfituar statusin e jetimit;

b) Nxenes që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;

c) Nxenes që janë identifikuar e trajtuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ç) Nxenes që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Bazuar ne shkresen e Ministrise se Arsimit dhe Sportit me nr. Prot. 973/1 te dates 29.10.2025 per Bashkine Kucove, jane miratuar 9 (nente) bursa dhe u shperndane tek aplikantet e meposhtem.

1. Aplikanti Glarentiola Sulo Kapllani

2. Aplikanti Roela Besnik Alimetaj

3. Aplikanti Eldison Tafil Veisllari

4. Aplikanti Edison Altin Domi

5. Aplikanti Leandro Nikollaq Ziu

6. Aplikanti Geri Bledar Pirja

7. Aplikanti Klevis Izet Pirja

8. Aplikanti Daut Ismet Hoxha

9. Aplikanti Artur Përparim Lamaj

Keta aplikante jane trajtuar me burse te plote per shkak te te ardhurave te pamjaftueshme , duke pasur per baze nivelin ekonomik te familjeve te tyre .

Bashkelidhur ketij relacioni po japim tabelen e aplikanteve , aneksin nr. 1 te VKM Nr 666 date 10.10.2019 te Keshillit te Ministrave dhe Projekt-Vendimin per shperndarjen e bursave .

**Drejtore e Q.E. Arsimit**
**Kozeta Mara**

2025

**KRYETARI I BASHKISE**
**Kreshnik HAJDARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

**Tabela e aplikantëve Shkolla e Mesme**

| Nr. | Emri Atesia Mbiemri | Shkolla e Mesme e fituar | Te ardhurat familjare | Nr. anetar/ familje | Te ardhurat p/fryme | Masa e burses |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Klevis Izet Pirja | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 6 | — | Bursa e plote |
| 2 | Geri Bledar Pirja | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 5 | — | Bursa e plote |
| 3 | Leandro Nikollaq Ziu | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 2 | — | Bursa e plote |
| 4 | Edison Altin Domi | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat. Drejtimi Mekanik | 9000 | 1 | 9000 | Bursa e plote |
| 5 | Eldison Tafil Vaisllari | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Mekanik. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 6 | Daut Ismet Hoxha | Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli "Berat Drejtimi Elektronike | 40000 | 2 | 20000 | Bursa e plote |
| 7 | Roela Besnik Alimetaj | Shkolla e Mesme Pofesionale "Kristo Isak" Berat Drejtimi mesimor Sherbime Sociale dhe Shendetsore. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 8 | Glarentiola Sulo Kapllani | Shkolla e Mesme Pofesionale "Kristo Isak" Berat Drejtimi mesimor Hoteleri-Turizem. | — | 4 | — | Bursa e plote |
| 9 | Artur Përparim Lamaj | Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Cela" Durres.Drejtimi mesimor Hoteleri-Turizem. | — | 4 | — | Bursa e plote |

3925
31.10.2025

D. Z. A
për zbatim
Kryetari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT, AFTËSIMIT DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. 977 prot.

Tiranë, më 24.10.2025

**Lënda:** Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik, për vitin shkollor 2025-2026.

BASHKISË Kuçovë

**I nderuar Kryetar i Bashkisë,**

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 666 Datë 10.10.2019, pika 7, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, ju dërgojmë planin e bursave për klasën e 10 (vitin e parë), për vitin mësimor 2025-2026 për shkollat e arsimit të mesëm profesional si më poshtë vijon:

| NR | Qarku | Emri i Bashkisë | Nr i bursave për Arsimin Profesional per vitin shkollor 2025-2026 |
|---|---|---|---|
| 1 | | Berat | 55 |
| 2 | | Ura Vajgurore | 25 |
| 3 | BERAT | Kuçovë | 15 |
| 4 | | Skrapar | 15 |
| 5 | | Poliçan | 10 |
| 6 | | Dibër | 65 |
| 7 | DIBER | Bulqizë | 30 |
| 8 | | Mat | 20 |
| 9 | | Klos | 18 |
| 10 | | Durrës | 135 |
| 11 | DURRËS | Shijak | 15 |
| 12 | | Krujë | 30 |
| 13 | | Elbasan | 210 |
| 14 | | Cërrik | 55 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 15 | | Belsh | 25 |
| 16 | ELBASAN | Peqin | 35 |
| 17 | | Gramsh | 25 |
| 18 | | Librazhd | 40 |
| 19 | | Prrenjas | 20 |
| 20 | | Fier | 95 |
| 21 | | Patos | 15 |
| 22 | FIER | Roskovec | 18 |
| 23 | | Lushnjë | 35 |
| 24 | | Divjakë | 15 |
| 25 | | Mallakastër | 15 |
| 26 | | Gjirokastër | 8 |
| 27 | | Libohovë | 5 |
| 28 | | Tepelenë | 7 |
| 29 | GJIROKASTËR | Memaliaj | 5 |
| 30 | | Përmet | 5 |
| 31 | | Këlcyrë | 5 |
| 32 | | Dropull | 5 |
| 33 | | Korçë | 95 |
| 34 | | Maliq | 58 |
| 35 | KORÇË | Pustec | 4 |
| 36 | | Kolonjë | 10 |
| 37 | | Devoll | 20 |
| 38 | | Pogradec | 80 |
| 39 | | Kukës | 20 |
| 40 | KUKËS | Has | 20 |
| 41 | | Tropojë | 10 |
| 42 | | Lezhë | 65 |
| 43 | LEZHË | Mirditë | 30 |
| 44 | | Kurbin | 30 |
| 45 | | Malësi e Madhe | 25 |
| 46 | | Shkodër | 80 |
| 47 | SHKODËR | Vau-Dejës | 35 |
| 48 | | Pukë | 15 |
| 49 | | Fushë-Arrëz | 15 |
| 50 | | Tiranë | 300 |
| 51 | | Kamëz | 100 |
| 52 | TIRANË | Vorë | 18 |
| 53 | | Kavajë | 50 |
| 54 | | Rrogozhinë | 15 |
| 55 | | Vlorë | 115 |
| 56 | | Selenicë | 20 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 57 | | Himarë | 5 |
| 58 | VLORË | Sarandë | 25 |
| 59 | | Konispol | 5 |
| 60 | | Finiq | 5 |
| 61 | | Delvinë | 5 |
| | | **TOTALI** | **2351** |

**Gjithashtu ju sjellim në vëmendje rëndësinë e miratimit të bursave për nxënësit e shkollave të mesme profesionale, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019, "Për përcaktimin e kuotave financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe të kritereve për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike", pika 14. Këto bursa janë një mbështetje e rëndësishme për nxënësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendim dhe duhet të miratohen brenda afateve ligjore të parashikuara.**

**Nisur nga problematikat e hasura në vitet e mëparshme, si vonesat në marrjen e vendimeve nga Këshillat Bashkiakë, mungesa e dokumentacionit në kërkesat për çeljen e fondit të bursave, mosdhënia e bursave në kohë, si dhe në disa raste mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019, kërkojmë që për vitin shkollor 2025-2026 të veproni në përputhje me këtë vendim, duke respektuar:**

**a) Afatet ligjore për dorëzimin dhe miratimin e dokumentacionit;**
**b) Kriteret për përfitimin e bursave;**
**c) Detyrimin për raportim dhe transparencë ndaj ministrive përkatëse, sipas parashikimeve të VKM nr. 666.**

Në rastet kur numri i bursave të planifikuara për vitin e parë nuk është i mjaftueshëm, ju informojmë se jemi të gatshëm të shqyrtojmë mundësinë e shtesës së tyre, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e paraqitura.

**Bashkëlidhur shkresës gjeni Shtojcën nr. 1: Lista e shkollave të arsimit profesional publik.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**MINISTER**

**Delina Ibrahimaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
TIRANË

# VENDIM
## Nr. 666, datë 10.10.2019

## PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE E TË PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, SI DHE FORMAT E TJERA TË PËRKUJDESJES NDAJ KATEGORIVE TË VEÇANTA NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE

*(Ndryshuar me VKM nr. 752, datë 30.11.2019, nr. 854, datë 24.12.2019; nr.* 511, datë 27.7.2022*)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit19, tëligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", tënenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12,të ligjit nr. 57/2019, "Përasistencën sociale nëRepublikën e Shqipërisë",dhe tëligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:

2.1 Kriteri ekonomik:

a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipaspasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;

b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe qëakomodohen në konvikte publike;

*c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.*

2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare9 (nëntë) deri në10 (dhjetë).

2.3 Kriteri joekonomik:

a) nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit;

b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

*c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor;*

ç)nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;

dh)nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekinarsimin e mesëm profesional;

e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzoredhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ë)nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit tëKontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave tëArmatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

f) nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;

*g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.*

*gj) Nxënëset, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja "f", e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës.*

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimorsi dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëselistën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.

2.4 Kriteri idegëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm:

a) nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesionalnë drejtimet mësimorebujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit;

*b) Shfuqizuar.*

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të sajkur:

a) janë ndarë nga trungu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) deklarohenmbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollëspërfrekuentimineprocesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiarenuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

6. Ministria përgjegjëse për arsimin,në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursavepër nxënësite arsimit parauniversitar, të cilin e dërgonnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se muaji tetor.

7. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me ofruesit publikë të arsimit profesional, harton planin e shpërndarjes së bursavepër hyrjet e reja (në vitin e parë),të cilinedërgonnë njësitë evetëqeverisjes vendore, jo më vonë se muajitetor.

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2,2.3 e2.4, të këtij vendimi.

9. Bursat e nxënësve për vitin e parë (klasën e 10) shqyrtohen dhe miratohen nga këshilli bashkiak, sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të kuotës financiare/kuotës ushqimore (bursës).

10. Nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë vitin e parë (klasën e 10) me vendim të këshillit bashkiak ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, të cilëve nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës, e përfitojnë bursën deri në përfundim të viteve të shkollimit.

*10.1 Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli bashkiak, sipas vendndodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhës nga këshilli bashkiak i njësive të vetëqeverisjes vendore.*

11. Nxënësit e shkollave profesionale, të cilët ndjekin vitin e dytë në drejtimet mësimorebujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, dhe nxënëset (vajza), sipas shkronjës "f", të pikës 2.3, të cilët kanë përfituar bursë në vitin e parë dhe në vitin shkollor paraardhës nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit.

12. Të gjithë nxënësit/prindërit dhe drejtoritë e shkollave profesionale, për nxënësit që regjistrohen për herë në klasën e 10, të cilët përfitojnë bursë sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi,i dërgojnë zyrtarisht kërkesat për miratimin e bursës në njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të përhershëm të nxënësit.

13. Nxënësit, të cilët gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore kanë përfituar bursë nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e përfitojnë atë edhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore ose të kuotës financiare, në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve, të çelur pranë bankave të nivelit të dytë.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendoreduhet t'u dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se muajidhjetori çdo viti, drejtorive të shkollave të arsimit profesional dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitarvendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

*14.1 Vetëm për vitin shkollor 2019–2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet tu dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se muaji janar i vitit 2020, drejtorive të shkollave të arsimit profesional dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.*

15. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojnë zyrtarisht, çdo tre muaj, pranë ministrisëpërgjegjëse për arsimin për fondet buxhetore të shpenzuara dhe numrin e nxënësve të arsimit parauniversitar dhe të arsimit profesional,që trajtohen me kuota ushqimore në konvikte dhe bursa.

16. Për nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë, drejtorët e shkollave të arsimit profesionalsi dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar dërgojnë zyrtarisht, në datën 5 të çdo muaji, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë.

17. Nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë, përfitojnë çdo vit, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë institucionet shtetërore.

18. Nxënësve, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, invalidit paraplegjik, tetraplegjik, statusin ligjor të personave që nuk shikojnë, të personave që nuk dëgjojnë, u sigurohen falas akomodimi/fjetja, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet pas paraqitjes së librezës, kartës shëndetësore dhe epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

19. Nxënësit jetimë, të cilët ndjekin procesin mësimor në institucionet publike të arsimit parauniversitar, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

20. Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët ndjekinshkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

21. Nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psiko-sociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit, me një kuotë ushqimore (drekë) me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

22. Nxënësve të arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5km dhe që akomodohen në konvikte publike, bursa u jepet në formën e kuotës ushqimore. Në asnjë rast, bursa nuk jepet në formën e kuotës financiare.

*23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë. Kuota mujore e bursës për nxënësit konviktorë u jepet në formën e kuotës ushqimore, si dhe shpenzimet vetjake të dhëna te pasqyra nr. 2 u paguhen me para në dorë këtyre nxënësve. Nxënësve, të cilët nuk jetojnë në konvikt dhe plotësojnë kriteret për bursë, u paguhet vlera e plotë e bursës pranë bankave të nivelit të dytë në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësit.*

24. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë sipas rezultateve të arritura, jashtë kriterit ekonomik, tëakomoduar në konvikte ose jo, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve.

25. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë në arsimin profesional, sipas shkronjave "dh" e "f", të pikës 2.3, dhe shkronjës "a", të pikës 2.4, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve.

26. Njësitë e vetëqeverisjes vendore realizojnë pagesën e bursës mujore për nxënësit përfitues vetëm pasi drejtorët e shkollave profesionale konfirmojnë zyrtarisht, brenda datës 5 të çdo muaji, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, informacionin për ndjekjen e shkollës/mësimit për nxënësit që përfitojnë bursë.

27. Nxënësve, të cilët nuk ndjekin mësimin/shkollën apo praktikën profesionale pa shkaqe të ligjshme, u ndërpritet bursa menjëherë.

28. Masa e bursës dhe kuota financiare ushqimore ditore për nxënësit jepet, respektivisht, sipas pasqyrave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

*29. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, jep jo më pak se 2 500 (dy mijë e pesëqind) bursa.*

*30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.*

31. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

*31.1 Përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, anëtarë të familjes së personave që kanë humbur jetën ose janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.Institucionet arsimore vendore përkatëse, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, identifikojnë nxënësit dhe dërgojnë listat e nxënësve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.*

32. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave, është muajidhjetor.

33. Vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afativetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse.

34. Vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit për nxënësit/prindërit/përfaqësuesit ligjorë, komunitetin, median dhe institucionet e tjera qendrore apo vendore, publike ose private.

*34/1. Grupet vulnerabël të nxënësve përfitojnë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbështetje nga punonjës të caktuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në rolin e mediatorit për këto*

*grupe, për t'i mbështetur në funksion të ndërgjegjësimit dhe të përmirësimit të aksesit të tyre në arsim. Mediatorët shërbejnë për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis grupeve vulnerabël dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, në funksion të rritjes së frekuentimit të procesit mësimor.*

*34/2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, u ofrojnë nxënësve romë dhe egjiptianë programe të veçanta pas mësimit për kryerjen e detyrave mësimore ose marrjen e mësimeve plotësuese.*

35. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe ofruesit earsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pasbotimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

PASQYRA NR. 1
KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS
*(Ndryshuar me vendimin nr.* 511, datë 27.7.2022*)*

| Nr. | Përbërja familjare | Përfitojnë bursa | Përfitojnë gjysmëbursa | Me pagesë |
|---|---|---|---|---|
| | *Për qytetin* | *Me të ardhura mujore, lek/frymë* | *Me të ardhura mujore, lek/frymë* | *Me të ardhura mujore, lek/frymë* |
| 1 | Për familjet me 2 persona | deri 4500 | 4,500–5000 | mbi 5000 |
| 2 | Për familjet me 3 persona | deri 4200 | 4200–4,800 | mbi 4,800 |
| 3 | Për familjet me 4 persona | deri 4100 | 4100–4,600 | mbi 4,600 |
| 4 | Për familjet me 5 persona | deri 4000 | 4000–4,500 | mbi 4,500 |
| 5 | Për familjet me 6 persona | deri 3800 | 3,800–4,300 | mbi 4,300 |
| 6 | Për familjet me 7 persona | deri 3500 | 3500–4,200 | mbi 4,200 |
| 7 | Për familjet me 8 persona | deri 3200 | 3200–4,000 | mbi 4,100 |

PASQYRA NR. 2
MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (NË LEK)
*(Ndryshuar me vendimin nr.* 511, datë 27.7.2022*)*

| Nr. | Kategoritë e bursave sipas shkollave | Kuotat e bursës mujore në lekë | | | Financimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Lekë për kuotë ushqimi* | *Shpenzime vetjake (higjienë personale, mjete mësimore)* | *Totali i kuotës* | *Financimi nga nxënësi/prindër* | *Financimi nga shteti* |
| 1 | **Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme** | | | | | |
| | a) Bursa | 6670 | 650 | 7320 | 0 | 7320 |
| | b) Gjysmëbursa | 6670 | 650 | 7320 | 3660 | 3660 |
| | c) Me pagesë | 6670 | 650 | 7320 | 7320 | 0 |
| 2 | **Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimi Special** | | | | | |
| | a) Bursa | 7250 | 650 | 7,900 | 0 | 7,900 |
| | b) Gjysmëbursa | 7250 | 650 | 7,900 | 3950 | 3950 |
| | c) Me pagesë | 7250 | 650 | 7,900 | 7,900 | |
| 3 | **Për nxënësit jetimë** | 7250 | 650 | **7,900** | **0** | **7,900** |

PASQYRA NR. 3
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
*(Ndryshuar me vendimin nr.* 511, datë 27.7.2022*)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. 4416 Prot. Kuçovë, më 05. 12 : 2025

Lënda: Relacion "Për disa ndryshime në emërtimin e rrugëve të qytetit të Kuçovës".

## KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË

Pranë Bashkisë Kucovë janë paraqitur kërkesat e qytetarëve, për vlerësimin e figurave të të afërmëve të tyre, Znj.Gëzime Leskaj, Z.Guri Aliaj dhe Z.Genci Hasani, si persona me një kontribut të madh në fusha të ndryshme të jetës në qytetin e Kuçovës.
Bashkia Kuçovë ka si prioritet lehtësimin e sistemit të adresave për qytetarët si dhe për të vlerësuar figurat që kanë dhënë kontribut për qytetin tonë, paraqet ndryshimet e segmetit rrugor Dora D'Istria në "Guri Aliaj", ndryshimin e emërtimit të rrugës "Adriatiku" në rruga "Genc Hasani", ndryshimin e emërtimit të degëzimit të rrugës "Nënë Tereza" në rruga "Gëzime Leskaj".
Mw poshtw po ju pwrshkruajmw historikun e figurave tw propozuara:
*Kontributi i Z. Guri Aliaj në Kuçovë*
Guri Aliaj lindi më 20 prill 1958 në Kuçovë. Arsimin 8-vjeçar e kreu në shkollën "Gaqi Karakashi", arsimin e mesëm në gjimnazin e Kuçovës. U diplomua për Inxhinieri Ndërtimi në Universitetin Politeknik të Tiranës më 1983. Pas studimeve punoi në Ndërmarrjen e Ndërtimit Berat si Inxhinier dhe Kryeinxhinier zbatimi dhe Kryetar i Degës Teknike.
Ka punuar për disa vite si Kryetar i Degës Teknike Komunale Kuçovë dhe Përgjegjës i Byrosë së Projektimeve ku ka dhënë kontributë në projektimin, ndërtimin dhe rikonstruksionin e disa objekteve në qytetin e Kuçovë, ku ndër më kryesoret përmendim:

- Projektimi i godinës së Ish Telekomit, i pallateve 5 kt ( i Uzinës Mekanike të Naftës, i Nxjerrjes së Naftës) etj.
- Ndërtimi i Shkollës 9 – Vjeçare " Koço Korçari", i depos së ujit Kuçovë, etj.
- Rikonstruksioni i Kishës Katolike, i Zyrave të Drejtorisë së Bujqësisë, i godinës së Poliklinikës Qendrore dhe i disa rrugëve kryesore të qytetit.

Gjithashtu ka dhënë kontributin e tij si anëtar i Komisionit Qytetar, anëtarë i Këshillit Bashkiak dhe President i Dhomës së Tregtisë.

*Kontributi i Genci Hasani*
Genci Hasani lindi në Korçë më 1 Janar 1938. Familja u transferua në Kuçovë kur ai ishte 6 – vjeç. Arsimi 7 – vjeçar e kreu në shkollën " Gaqi Karakashi", arsimin e mesëm e kreu në shkollën " Jordan Misja" Tiranë.

U diplomua për dramaturgji në vitin 1972 në Akademinë e Lartë të Arteve. Për 25 vjet ka dhënë kontributë në zhvillimin e artit e kulturës në qytetin e Kuçovës si Drejtor i Shtëpisë së Pionerit " Kristaq Laçka", duke organizuar veprimtari artistiko – kulturore me fëmijët e qytetit. Ka interpretuar role të ndryshme në disa filma shqiptar. Si regjisor ka dhënë kontributin e tij në disa qytete të vendit, kontributë për të cilën është vlerësuar me "Medalje Artë" në qytetin e Vlorës. Në vitin 2012 është vlerësuar me titullin "Qytetar Nderi" i Kuçovës.

*Kontributi i Znj. Gëzime Asim Leskaj*

Znj. Gëzime Asim Leskaj lindi më datë 25.02.1926 në fshatin Salari të rrethit Tepelenë, në një familje me tradita atdhetare patriotike. Sapo kishte mbushur 16 vjeçe, kjo vajzë e re trime labe do të rreshtohet në radhët partizane të brigadës XII – Sulmuese, ku do të spikas mençuria dhe trimëria deri në çlirimin e plotë të vendit. Në vitin 1946 vjen me banim në qytetin e Kuçovës. Do të jetë gruaja e parë shqiptare që do të fillojë punë marshiniste ku asokohe prej vitit 1931 deri në vitin 1966 eksistonte " minihekuradha"(10 km), e ndërtuar nga italianët e shoqërisë së naftës "AIPA" e cila shërbënte për të transportuar materialet nga Ura – Vajgurore (Dimal) deri në Mal – Kozare (pra shërbente për zonat e naftës). Dekovili që ishte 4 – 5 vagona, shërbente edhe për transportin e punëtorëve. Znj. Gëzime Leskaj do të jetë historikisht gruaja e parë e qytetit Kuçovë që do të drejtoj Dekovilin. Gjatë kësaj karrierës Znj. Është dekoruar me tituj e stimuj të ndryshëm nga Autoritetet e Kohës.

**Nga sa më sipër, është në vlerësimin tuaj të miratoni ndryshimet e emërtimeve të këtyre rrugëve.**
**Bashkëlidhur keni dhe Planvendosjet, ku janë përcaktuar ndryshimet e emërtimeve të këtyre rrugëve .**

Konceptoi: Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Figurave
Z. Sybi Shehu

**KRYETARI I BASHKISË**
**KRESHNIK HAJDARI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KUÇOVË**
**KOORDINATORI I PERFORMANCES**

Nr. 4408 Prot.

Kuçovë, më 05 / 12 / 2025

Lenda: Informacion mbi "Raportin e Performances se Bashkise Kucove"

Drejtuar : **KESHILLI BASHKIAK Kuçove**.

Ne mbeshtetje te neneve 11 dhe 12 te Kreut IV te Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", ne cilesine e Koordinatorit te Performances se bashkise Kucove i ngarkuar ad-hoc me Urdherin e Kryetarit te Bashkise me nr.164 date 17.07.2025,

Ju percjell bashkelidhur kesaj shkrese : extraktin e "Raporti i Performances se Bashkise Kucove 2025"( bazuar ne te dhenat e kofirmuara te vitit ushtrimor 2024) pergatitur nga Projekti "Bashki te Forta"

Per arsye te volumit te madh te ketij Raporti do te gjeni te sintetizuar te dhenat dhe treguesit kryesor te performances. Teksti I plote I Raportit eshte publikuar nga data 17.11.2025 ne faqen web te bashkise Kucove

Faleminderit per bashkepunimin!

**KOORDINATOR I PERFORMANCES**

ADRIATIK CARKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SEKRETARIA
BASHKIA KUÇOVE



# Raporti I Performancës

Bashkia Kuçovë

2025

agjencia për mbështetjen

amvv

e vetëqeverisjes vendore

Ky botimm bështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë,i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtëbotim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

Sweden
Sverige

Ky raport paraqet një analyze të performances së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë document evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale", I cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky process reformash, I shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligji "Për financat vendore" (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale.

Miratimi I ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", I hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi I pyjeve dhe kullotave;

2. Administrimi dhe menaxhimi I kanaleve kulluese dhe ujitëse;

3. Administrimi dhe menaxhimi I arsimit parashkollor;

4. Administrimi dhe menaxhimi I rrugëve rurale;

5. Administrimi dhe menaxhimi I mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi I performances në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura perms një procesi konsultues me ekspertë tematikë.

Strategjia e zhvillimit e Bashkisë Kuçovë përfaqëson një plan afatmesëm dhe gjithëpërfshirës që synon të promovojë rritjen ekonomike, zhvillimin social dhe përmirësimin e infrastructures në territorin e bashkisë. Ky document bazë identifikon potencialet kryesore të zonës, sfidat ekzistuese dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm.

